



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.534/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Burim Morinës kandidat për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Kamenicë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** si e pa lejuar ankesa e Burim Morinaës kandidat për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Kamenicë, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.10.2014, nga Burim Morina kandidat për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Kamenicë, në të cilën pretendon se në fletvotimin nr. 1024D/1 në fshatin Koretin të Kamenicës i janë keqpërdorur votat e tij nga ana e komisionerëve gjatë numërimit. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë klasë kanë votuar rreth 15 dajë të babait të tij të cilt kanë deklaruar se e kanë votuar ate dhe AKR-në, ndërsa në këtë klasë ai ka vetëm një vote. Parashtruesi i ankese kërkon që të bëhet rinumërimi i votave.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankeses gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimin 1024D/01, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit të Burim Morinës, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i mohohet e drejta

që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZLAnr.534/2017 më datën 31.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Hasan Shala**



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.***